



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:142143

Datë: 28.01.2021

Numri i dokumentit: 01454421

P.nr.995/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren e vetme gjykuese Hakile Ilazi dhe me zyrtarin ligjor Gazmend Bytyqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit **E.E.**, për shkak të veprës penale **Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par 6 të KPRK-së**, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj **PP/II.nr.1362/20** të datës **19.11.2020**, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të prokurores së shtetit **Mimoza Syla Hyseni**, të akuzuarin **E.E.** dhe të dëmtuaren - e mitura **A.B.** me përfaqësuesin e saj ligjorë babain **A. B.**, më datën 15.01.2021, mori dhe publikisht shpalli, kurse me datë 28.01.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E. H.**, i lindur më, me numer personal, nga i ati **L.**, e ëma **A.**, e vajzërisë **B.**, me vendbanim në Ferizaj,rr. “.....” pn,i pa martuar, student, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datën më datën 27.08.2020, rreth orës 20:00, në rr. “Zenun Beqa” - Ferizaj, afër palestres së vogël të sportit duke e drejtuar automjetin e markës “.....”, zgjyrë e zezë, me targa të regjistrimit, në kundërshtim me nenin 53.1 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik, jeten e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë

që nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës në vendbanim, ashtu që me pjesen e përparme të automjetit e godetë fëmijën – të dëmtuaren A.B., e cila ishte duke e kaluar rrugën nga ana e majtë në anën e djathtë në drejtim të lëvizjes së njësisë një, me ç’ rast e dëmtuara pëson lëndime të rënda trupore, të përshkruara si në akt-ekspertimin mjeko-ligjor të datës 30.10.2020,

- me të cilën ka kryer veprën penale “Rrezikim i trafikut publik” nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 të KPRK-së

Andaj, gjykata ne baze të neneve 4,6,17,21,38,43, dhe 69 të KPRK-së si dhe neni 365 të KPPK-së,

GJYKON

Të akuzuarin E.E., me DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 700.00 € /shtatëqind euro/ të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë brenda afatit prej 30/tridhjetë/ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuarit nuk mundet apo nuk dëshironë ta paguajë dënimin me gjobë, i njëjti në pajtim me nenin 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për njëzetë /20/ euro gjobë të papaguara, i akuzuari do të vuajnë një /1/ ditë burg.

Obligohet i akuzuari, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për (ekspertizën e komunikacionit, si dhe për ekspertizën mjeko ligjore të i paguaj shumën prej 60.88 €, /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjete e tetë cent/ shpenzimet e paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 /njëzetë/ €, si dhe për kompensimin e Viktimave të Krimit obligohen ta paguajnë shumën prej 30 (tridhjetë euro), pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit, në afatin prej 30 / tridhjetë/ ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

E dëmtuara (e mitura) A.B. nga Ferizaj, rr. “.....” për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën **PP/II.nr.1362/20** të datës **19.11.2020**, ka ngarkuar të akuzuarin E.E., për shkak të veprës penale “Rrezikim i trafikut publik” nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas kësaj aktakuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 15.01.2021. në të cilin shqyrtim, përfaqësuesi i aktakuzës prokurorja e shtetit Mimoza Sylja Hyseni, mbeti në tërsi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprave penale duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj.

I akuzuari pasi është njoftuar nga gjykata në kuptim të nenit 246 të KPRK-se, lidhur me të drejtën për tu deklaruar lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar është deklaruar fajtor për veprën penale duke shprehur keqardhje dhe penduar të thellë, i njëjti shton se është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe kërkoj falje publike të dëmtuarës si dhe prindërve të saj, aksidentin e ka shkaktuar nga pakujdesia dhe nuk kam pasur qëllim të e lëndoj të dëmtuarën , i premtom gjykatës se nuk do të përsëris vepra tjera penale e as të ngjashme, e lut gjykatën që të i shqiptoj një dënim sa më të but.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtarja e vetme gjykuese, në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në këtë fazë të procedure penale pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe pranimi mbështetet edhe me provat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata të mere për bazë pranimin e fajësisë dhe pendimin për veprën penale që akuzohen.

Përfaqësuesi ligjorë – babai i të dëmtuarës deklaroi se: sa i përket shqiptimit të dënimit në këtë i'a lë gjykatës, por, do të paraqesë kërkesë pasurore – juridike.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par.1 nën.par.1 dhe par.4 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: raporti i policit hetues i datës 27.08.2020, deklarata e të pandehurit e datës 27.08.2020, deklarata e të dëmtuarës e datës 18.11.2020, raporti mjekësor i datës 27.08.2020 i lëshuar nga SHSKUK dhe fletëlëshii me ekspertizë nga data 28.08.2020-01.09.2020 e lëshuar nga QKUK Prishtinë, akt ekspertimi i ekspertit të mjekësisë-ligjore i datës 30.10.2020, konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 12.11.2020, fotografitë si dhe shkresat tjera të cilat gjinden në lëndë.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës “Rrezikim i trafikut publik” nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të akuzuarit mori pranimin e fajësisë, pendimi për veprën e kryer, moshën e të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale ,nuk kemi të dhëna se i akuzuari ka qen i dënuar me ndonjë akgjykim të formës së prerë, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, i akuzuari vërtetoi dënim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë për të akuzuarin është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par. 2, nën par. 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.896/20 me datë 28.01.2021

Zyrtari Ligjor
Gazmend Bytyqi

Gjyqtarjae vetme gjykuese,
Hakile ILAZI

Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit Kosovës, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh. Kurse i dëmtuarit mund të paraqes ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.